



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

QENDRA NDËRINSTITUCIONALE E
RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR

Nr. 2815/ Prot. Tiranë, më 29.09.2023

Nr. 296/2 Prot. Tiranë, më 29.09.2023

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 134 , Datë 29/09/2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN E PËRBASHKËT NR. 10, DATË 10.07.2023, "PËR
MIRATIMIN E KALENDARIT PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË
REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK
2023 – 2024"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të vendimit nr. 436, datë 03.06.2020, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim", i ndryshuar dhe të udhëzimit nr.12, datë 30.06.2023, "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë",

URDHËROJ

1. Në kalendarin e miratuar sipas urdhrit të përbashkët nr.10, datë 10.07.2023, "Për miratimin e kalendarit "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2023 – 2024", në shtojcën nr.1, në kolonën e referencave në pikën 2, gërma J, Kreu II i udhëzimit nr.12, datë 30.06.2023, bëhen ndryshimet sa më poshtë:

SHTOJCA NR. 1

Periudha/Datat			
Kreu II			
Procedurat e Aplikimit dhe regjistrimit të Kandidatëve në Programet e Studimeve me Karakter Profesional, në Programet e Studimeve të Ciklit të Parë dhe në Programet e Integruara të Studimeve të Ciklit të Dytë			
Nr.	Referenca në Udhëzim	Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit	
Kreu II			
		Ishte	Bëhet
1	J. Procedura e Aplikimit dhe Regjistrimit të Kandidatëve pas Përfundimit të Raundit të Dytë, pika 2	4-10 tetor 2023	4-18 tetor 2023



2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Drejtoritë Rajonale dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Për Qendrën e Shërbimeve Arsimore

Drejtor i Përgjithshëm

Znj. Aurora BALLIU

Për Qendrën Ndërinstitucionale

të Rrjetit Akademik Shqiptar

Drejtor i Përgjithshëm

Z. Arjan XHELAJ






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT PËR ARSIMIN DHE SPORTIN
DREJTORIA E POLITIKAVE TË ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR

Nr. 5081 Prot.

Tiranë, më 23.08. 2023

Lënda: Kthim përgjigje.

KONFERENCËS SË REKTORËVE

Tiranë

Për dijeni: QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE
Tiranë

QENDRËS NDËRINSTITUCIONALE TË RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR ✓
Tiranë

Të nderuar,

Në vijim të shkresës suaj nr. 23 prot., datë 9.8.2023, regjistruar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS) me nr. 5081 prot., datë 9.8.2023, me lëndë "Mbi udhëzimin nr. 12, datë 30.6.2023 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë"", ju informojmë se, merret parasysh kërkesa juaj për ndryshimin e afatit të procedurave pas përfundimit të raundit të II nga 4-10 tetor 2023 në 4-18 tetor 2023, dhe në vijim do të bëhen ndryshimet përkatëse në urdhrin e përbashkët të Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) nr.10, datë 10.7.2023 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2023 – 2024". Kërkesat e tjera të parashtruara në shkresën tuaj, të sipërcituar, do të mbahen në konsideratë për vitin e ardhshëm akademik.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin,

MINISTER

EVIS KUSHI

